

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E drejta ndërkombëtare ekonomike</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusilëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>MOD</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>8</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	
<b>Detajet kontaktuese:</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>E drejta ndërkombëtare ekonomike, si degë e të drejtës ndërkombëtare, përfshinë rregullat që aplikohen në raportet ekonomike në mes të shteteve sovraane, si dhe raportet ekonomike me element ndërkombëtar në mes të kompanive publike si dhe korporatave private, pra që involvojnë transaksione ekonomike që kalojnë kufinjtë.</p> <p>Përvec rregullave themelore që aplikohen në raportet ekonomike mes shteteve apo personave juridikë privat e publikw, kjo lëndë do të përfshijë edhe analizë të mjeteve për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare të natyrës ekonomike. Një analizë do t'i bëhet edhe punës së organizatave ndërkombëtare ekonomike.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është të studiojë parimet e përgjithshme të së drejtës ekonomike ndërkombëtare, zhvillimin e saj gjatë dekadave të fundit, rolin e shteteve në raportet e tyre ekonomike si dhe rolin e kompanive private në transaksionet ndërkombëtare.</p> <p>Lënda do të përfshijë edhe studim të organizatave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale të tregtisë, sic janë WTO (Organizata Botërore e Tregtisë), CEFTA (Central European Free Trade Agreement), NAFTA (North American Free Trade</p>

	<p>Agreement) dhe të tjera. Çështjet që dalin nga zbatimi i këtyre Marrëveshjeve poashtu do të studjohen, me fokus në zgjidhjen e kontesteve tregtare që lidhen me moszbatimin e pjesëve të caktuara të këtyre marrëveshjeve. Poashtu, do të studiohen edhe shembuj të traktateve bilaterale të investimeve (BIT) dhe kontestet e ndryshme që involvojnë shtete sovraane në ICSID (Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve).</p> <p>Në këtë lëndë, do të analizohen në vecanti edhe disa konventa ndërkombëtare që kanë unifikuar rregullat e aplikueshme të tregtisë ndërkombëtare. Prandaj, një numër i rasteve të gjykatave dhe arbitrazhit, ku është aplikuar kjo konventë, do të studiohen nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kuptojnë dhe shpjegojnë parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ekonomike;</li> <li>2. Kuptojnë rregullat që përcaktojnë raportet ekonomike në mes të shteteve sovraane;</li> <li>3. Kuptojnë rolin e kompanive/personave juridikë në raportet ekonomike me element ndërkombëtar;</li> <li>4. Njohin dhe përdorin procedurat e përdorura nga gjykatat apo arbitrazhet në zgjidhjen e kontesteve të natyrës ekonomike ndërkombëtare;</li> <li>5. Përdorin dhe analizojnë raste dhe dokumente ligjore në kontekst të problemeve që lindin gjatë interpretimit të konventave ndërkombëtare që kanë rregulluar këtë fushë.</li> </ol>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15/javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15/javë	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15/javë	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare,pune grupore	4	3	12
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
<b>Totali</b>	<b>24</b>		<b>200</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Ligjëratat e kësaj lënde do të jenë interaktive dhe do të përfshijnë diskutime të shumta me studentët për materiale që ata do të kenë mundësi t'i studiojnë paraprakisht. Meqë një pjesë e rëndësishme e ligjeratave i dedikohet rasteve të vendosura nga gjykatat ose arbitrazhi, studentët do të luajnë rolet e palëve në gjykatë e arbitrazh, duke përfaqësuar palët në atë kontest. Msimdhënësja do të përdorë metodën sokratike gjatë ligjëratave, në mënyrë që të ketë angazhim sa më interaktiv në klasë.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>10% - Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjërata  10% - prezentimi i rastit që i caktohet studentit  10% - punë grupore (përfaqësimi i palëve në kontest ndërkombëtar biznesor)  20% - test mes-semestral  50% - provimi final</p> <p>Do të ketë një politikë rigoroze në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës.Pjesëmarrja</p>		

	<p>aktive, përmbajtjesore dhe e rregullt në ligjërata vlerësohet me 10 për qind (%). Nëse pjesëmarrja, në <u>cilësi</u> dhe <u>vijueshmëri</u>, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për të përcaktuar këtë i takon profesorit të lëndës.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p><b>1. Mehdi Hetemi</b> E drejta nderkombetare tregtare –afariste Universiteti i Prishtines, 2007</p> <p><b>2. Matthias Herdegen</b> Principles of International Economic Law Oxford University Press, 2013</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Materiale shtesë nga OBT (WTO)</i></li> <li>• <i>Materiale shtesë nga ICSID (Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve)</i></li> <li>• <i>Ligjet e Kosovës në fushën e investimeve, detyrimeve, tregtisë, etj.</i></li> <li>• <i>Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjet Ndërkombëtare të Mallrave</i></li> <li>• <i>Materiale dhe artikuj të tjerë të përkthyer që do të dorëzohen nga mësimdhënësi</i></li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java 1</i>	<p><b>Hyrje në të drejtën ndërkombëtare ekonomike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmbajtja e Lëndës</li> <li>- Vlerësimi dhe Notimi</li> <li>- Përshkrimi i Planprogramit</li> <li>- Shpërndarja e Materialeve</li> <li>- Diskutime interaktive rreth pritjeve të studentëve</li> </ul>

<p><b>Java 2</b></p>	<p align="center"><b>Parimet e Përgjithshme të së Drejtës Ndërkombëtare Ekonomike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimi i të drejtës ndërkombëtare ekonomike</li> <li>- Ndërveprimi në mes të së drejtës vendore dhe të drejtës ndërkombëtare ekonomike</li> <li>- Fushat kryesore që mbulohen nga e drejta ndërkombëtare ekonomike</li> </ul> <p><i>Herdegen, Fq.3-11</i>  <i>Materiale/Artikuj shitesë të përgatitura nga mësimdhënësi i lëndës</i></p>
<p><b>Java 3</b></p>	<p align="center"><b>Subjektet e të drejtës ndërkombëtare ekonomike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Subjektet vs. akterët në të drejtën ekonomike ndërkombëtare</li> <li>- Shtetet, Kompanitë Shtetërore, Korporatat Private, Organizatat Ndërkombëtare, Organizatat Joqeveritare</li> </ul> <p><i>Herdegen, Fq.25-38</i>  <i>Materiale/Artikuj shitesë të përgatitura nga mësimdhënësi i lëndës</i></p>
<p><b>Java 4</b></p>	<p align="center"><b>Burimet Juridike të së drejtës ndërkombëtare ekonomike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullat e të drejtës ndërkombëtare që rregullojnë raportet ekonomike mes shteteve</li> <li>- Ligjet e Bashkimit Evropian</li> <li>- Lex mercatoria</li> <li>- Parimi i Sovranitetit në raportet ekonomike ndërkombëtare</li> <li>- Traktatet kryesore ndërkombëtare të fushës ekonomike</li> </ul> <p><i>Herdegen, Fq.42-25; 62-77</i>  <i>Materiale/Artikuj shitesë të përgatitura nga mësimdhënësi i lëndës</i></p>
<p><b>Java 5</b></p>	<p align="center"><b>Sistemi i OBT-së dhe Procesi i Anëtarësimit në këtë organizatë</b></p> <p align="center">WTO website – <i>KLIKO</i> ne: “What is the WTO”  <a href="http://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/whatis_e.htm">http://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/whatis_e.htm</a></p> <p align="center"><i>Shih kriteret dhe rregullat për anëtarësim në <a href="http://www.wto.org">www.wto.org</a></i></p>
<p><b>Java 6</b></p>	<p align="center"><b>Marrëveshjet Rajonale për Tregti të Lirë CEFTA dhe NAFTA</b></p> <p align="center">Materialet rreth CEFTA: <a href="http://ceftatradeportal.com">http://ceftatradeportal.com</a>  Materialet rreth NAFTA: <a href="https://www.nafta-sec-alena.org/Home/Welcome">https://www.nafta-sec-alena.org/Home/Welcome</a></p>
<p><b>Java 7</b></p>	

	<p align="center"><b>Investimet Ndërkombëtare dhe Traktatet Shumëpalëshe e Dypalëshe të Investimeve</b></p> <p align="center"><i>Herdegen, fq.375-411</i> <i>www.ICSID.COM</i></p>
<i>Java 8</i>	<p><b>E drejta ndërkombëtare tregtare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- E drejta nderkombetare kontraktuale</li> <li>- Traktatet ndërkombëtare që kanë unifikuar rregullat e tregtisë ndërkombëtare</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare që merren me tregti ndërkombëtare</li> </ul> <p><i>Materialet:</i> <a href="http://www.uncitral.org">www.uncitral.org</a> <a href="http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/text/treaty.html">http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/text/treaty.html</a></p>
<i>Java 9</i>	<p align="center"><b>Zgjidhja e Kontesteve Ekonomike Ndërkombëtare</b></p> <p align="center">Zgjidhja e Kontesteve në OBT: <a href="https://www.wto.org/english/tratop_e/dispu_e/dispu_e.htm">https://www.wto.org/english/tratop_e/dispu_e/dispu_e.htm</a></p> <p align="center">Zgjidhja e kontesteve tw investimeve nga ICSID <a href="http://www.icsid.org">www.icsid.org</a></p>
<i>Java 10</i>	<p align="center"><b>Arbitrazhi Ndërkombëtar Komercial dhe metodat e tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve</b></p> <p><u>Docs: U.N. Convention on Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards;</u> <a href="http://www.unictr.org">www.unictr.org</a> <a href="http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.text&amp;cid=98">http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.text&amp;cid=98</a></p>
<i>Java 11</i>	<p align="center"><b>Zgjidhja e Kontesteve Tregtare në Sistemin Evropian</b></p> <p align="center"><i>European Council Regulation (EC) No 44/2001 of 22 December 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters (Brussels Regulation)</i> <i>KLIKO NE : <a href="http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_012/l_01220010116en00010023.pdf">http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_012/l_01220010116en00010023.pdf</a></i></p>

<b>Java 12</b>	<b>Banka Botërore dhe institucionet e tjera financiare ndërkombëtare</b>  <i>Herdegen, fq.455-483</i>
<b>Java 13</b>	<b>Aplikimi në Kosovë i traktateve ndërkombëtare që rregullojnë çështje ekonomike</b>  <i>Ligje të selektuara të Kosovës të shpërndara tek studentet nga mësimdhënësi</i>
<b>Java 14</b>	<b>Aplikimi i Konventës CISG në tregti ndërkombëtare</b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- rregullat e formimit të kontratave ndërkombëtare për shitjen e mallrave</li> <li>- Obligimet e palëve (shitësit dhe blerësit)</li> <li>- Interpretimi i kontratave ndërkombëtare</li> <li>- Kompenzimi i dëmit dhe restitutio, në kontratat ndërkombëtare</li> </ul> <p style="text-align: center;">- -</p> <i>Teksti i CISG I përkthyer në Shqip Raste hipotetike dhe vendime të gjykatave e arbitrazheve</i>
<b>Java 15</b>	<b>Prezentimet e studenteve dhe përgatitje për provimin perfundimtar</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</i>